



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 04**

**Datë: 25. 01. 2024. Ora: 13:30**

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, krye shef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 01/2024**
- 3. Raportet e Këshillave të KQZ-së:**

#### **3.1.Këshilli për Çështje Ligjore**

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të kuvendit komunal në Prizren

#### **3.2.Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë**

-Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ-së në vëzhgimin e zgjedhjeve nacionale në Korenë e Jugut

- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Nr.10/2024 Për Shtesat dhe Kompensimet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve**

5. **Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Nr. 11/2024 Për Pranimin e Drejtorit të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

6. **Të ndryshme!**

---

1. **Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

Kryetari Radoniqi hapi mbledhjen dhe paraqiti rendin e takimit. Pas kësaj, **Burim Ahmetaj** nga Sekretariati këroi që të shtrohet një pikë e rendit të ditës lidhur me mbajtjen e një punëtorie mbi shqyrtimin dhe miratimin e rregullave zgjedhore mes datave 31 janar, deri më 2 shkurt.

**Arianit Elshani**, propozoi që të diskutohet në parim drafti final i Rregulloreve, jo të votohet sot por të diskutohet. Edhe unë do të doja ta diskutojmë, tha z. Radoniqi...

Anëtarët e KQZ-së me 10 vota për, miratuan rendin e ditës. Pastaj, lidhur me miratimin e procesverbalit nga mbledhja nr. 1/2024, z. Kurteshi tha se në një diskutim të tij në mbledhje, tha të plotësohet “përmbajtja” duke qenë se janë me rëndësi ato që kam diskutuar!

Me 9 vota për dhe një abstenim, u miratua procesverbali i mbledhjes nr. 01/2024.

**2.Raportet e Këshillave të KQZ-së:**

**Këshilli për Çështje Ligjore**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të kuvendit komunal në Prizren:

**Sami Hamiti:** Në mbledhjen e këshillit kemi shqyrtuar kërkesën e kuvendeve të Prizrenit dhe Prishtinës dhe që të dy këto kërkesa janë aprovuar në këshill, dhe janë proceduar në KQZ. Kështu, në kuvendin komunal në Prizren, Dafina Bllaca nga subjekti partiak PDK emërohet anëtare e këtij kuvendi duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm Simir Krasniqin.

Në Prishtinë, Arbër Limani nga subjekti partiak Lëvizja “Vetëvendosje!” emërohet anëtar i kuvendit komunal të Prishtinës duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm Besnik Mujecin.

Anëtarët e KQZ-së me 10 vota për miratuan këto dy zëvendësime.

Në vazhdim, lidhur me pikën e propozuar në fillim të mbledhjes z. Burim Ahmetaj, kryeshef i Sekretariatit tha se pas Sekretariati ka filluar përgatitjet për mbajtjen e një punëtorie lidhur me shqyrtimin e rregullave. Punëtorja do të mbahet brenda vendit për tri ditë pune, dhe se pjesërisht mbajtjen e kësaj punëtorie e mbështetë materialisht edhe OSBE.

**Alban Krasniqi**, tha se nesër ishte dashur të mbahet një takim i DOZ-it sepse, është mirë të sigurohet agjenda, kostoja dhe se meqë koha nuk pret, dhe pas kësaj të dërgohet edhe si material. Të konsiderohet pastaj se, është edhe program i punës përkufizimi në DOZ..

**Sami Kurteshi** tha se, mbasi që kemi të bëjmë me trajtimin e rregullave zgjedhore dhe të rregullave të brendshme, edhe nëse e kalojmë një ditë më shumë ne, e kemi shansin që të gjitha rregulloret ti miratojmë: të gjitha...

**Alban Krasniqi**, tha se mbase rregulloret e brendshme i kemi krye. Por dy –tri rregullore që i kemi me i krye, nuk mund të kryhen aq shpejt. Mendoj se mos të futen në agjendë rregulloret e brendshme sepse, ato në parim ato janë krye...

**Kreshnik Radoniqi**: Të akordohemi për datë, mendoj që s’kemi çka të votojmë... Në parim, po pajtohem.

**Ilir Gashi**, tha se po pyes lidhur me një peticion, është fjala për “peticionin e komunave veriore”. Është mirë ta dimë si është gjendja, sa peticione kane ardhur, a është zhvillue peticioni konform ligjeve në fuqi, a janë trajtue...?

**Kreshnik Radoniqi**, tha se kanë ardhur peticionet nga të katër komuna, dhe se verifikimi i nënshkrimeve do të bëhet ditëve në vijim. Nevojitet kohë sepse janë numër i madh i nënshkrimeve...

### **Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë**

Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ-së në vëzhgimin e zgjedhjeve nacionale në Korenë e Jugut:

**Kreshnik Radoniqi** tha se, është një ftesë nga Republika e Koresë së Jugut lidhur me vëzhgimin e zgjedhjeve nacionale atje. Vizita bëhet me shpenzimet e shtetit të Koresë. Nga data 4-12 prill, dhe se gjithëcka është e mbuluar materialisht. Kemi pasur në këshill diskutim, po edhe propozim. Jam propozuar unë dhe Alban Krasniqi.

E hapi diskutimi, sidomos nëse ka tjetër propozim.

**Arianit Elshani**, tha se vitin e kaluar ka qenë një modul i programit dhe se, po pyes nëse kjo ftesë i përmban të dy modulet...?

Burim Ahmetaj: Po, ashtu është por, festa është vetëm për modulin e parë të vëzhgimit, mirëpo planifikimi ynë apo interesimin e kemi shprehur do të jetë të realizohet deri në shtator, kështu që kemi kohë...

Pas diskutimeve, me 10 vota për anëtarët e KQZ-së miratuan propozimin që në vëzhgimin e zgjedhjeve në Koren e Jugut të marrin pjesë: Kreshnik Radoniqi dhe Alban Krasniqi.

**Kreshnik Radoniqi:** tani, janë çështjet e brendshme që i diskutojmë, ju kishim lutur ta lironi sallën...

---

**Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Nr.10/2024 Për Shtesat dhe Kompensimet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve**

**Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Nr. 11/2024 Për Pranimin e Drejtorit të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

**Të ndryshme!**